



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Nr 224/1 Prot

Datë 20 / 01 / 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për : Bashkimin e operatorëve ekonomik

- “Fled” shpk me nr nipt-i K17621104C, me adresë Lagjja " Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307 , Kuçovë .
- “Shkëlqimi 07” shpk me nr nipt-i K68121808W, me adresë Lagjja Fshati Belishov, rruga nacionale "Ballsh Fier", zona kadastrale 1143 numer pasurie 186/7.

Procedura e prokurimit : Procedurë e Hapur – Punë Publike.

Numri i referencës së procedurës : REF-79868-11-25-2020 .

Përshkrim i shkurtër i kontratës , objekti : “ **Rikualifikimi urban i lagjes Llukan Prifti** ”, me fond limit : **65 621 982** (gjashtëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e njëzetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) **lekë pa tvsh** .

Afati për ekzekutimin e kontratës : Do të jetë 5 (pesë) muaj nga data e lidhjes së kontratës .

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët **X**

Njoftojmë se në procedurën e prokurimit kanë ofertuar **4** (katër) operator ekonomik dhe konkretisht si më poshtë :

1. “**K-AAV**” shpk me Nr NIPT-i **L51506025C** me ofertë ekonomike : **64 227 070** (gjashtëdhjetë e katër milion e dyqind e njëzetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh.
2. “**Koloseu**” shpk me Nr NIPT-i **J72603129H** me ofertë ekonomike **64 768 330** (gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë) lekë pa tvsh .

3. Bashkimi i operatorëve ekonomik, “Fled” shpk me Nr NIPT-i **K17621104C** dhe “Shkëlqimi 07” shpk me Nr NIPT-i **K68121808W**, me ofertë ekonomike : **64 303 900** (gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e tre mijë e nëntëqind) lekë pa tvsh .
4. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Llazo” shpk me Nr NIPT-i **K24218401K** dhe “Leon Konstruksion” shpk me Nr NIPT-i **K71820009I**, me ofertë ekonomike : **57 634 750** (pesëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh .

* * *

Janë skualifikuar operatorët ekonomik ofertues si më poshtë :

1. “ **K-AAV** ” shpk me Nr NIPT-i **L51506025C** rezulton me mangësi në dokumentacion dhe konkretisht si më poshtë :
 - Nuk plotëson pikën për punë të ngjashme .
 - Nuk plotëson pikën për punësim mesatar jo më pak se 70 (shtatëdhjetë) punonjës për periudhën dhjetor 2019 – nëntor 2020, ka paraqitur vetëm 26 punonjës .
 - Nuk ka paraqitur dokumenta për inxhinier Hidroteknik, gjeolog dhe inxhinier infrastrukture transporti si drejtues teknik.
 - Nuk ka paraqitur punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik
 - Në licensën e shoqërisë nuk ka paraqitur pikat e kërkuara në DST si NP-4C, NP-12A, NS-5A .
 - Nuk ka paraqitur dokumenta për shumicën e mjeteve të kërkuara .
 - Nuk ka paraqitur dokumenta për impiant prodhim betoni, prodhim inertesh dhe linjë linjë prodhimi pllaka bordura.
2. “**Koloseu**” sh.p.k me Nr NIPT-i **J72603129H** rezulton me mangësi në dokumentacion dhe konkretisht si më poshtë :
 - Nuk ka paraqitur dokumenta për makinerit dhe mjetet e kërkuara.
 - Nuk ka paraqitur çertifikata ISO .
 - Nuk plotëson pikat në licensat profesionale .
 - Nuk ka paraqitur inxhinierët e kërkuar .
 - Nuk ka paraqitur punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të cilat janë të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA.
 - Nuk ka paraqitur dokumenta për impiant prodhimi betoni, prodhim inertesh, fabrikë asfalti dhe linjë prodhimi pllaka dhe bordura .
 - Nuk plotëson pikën për punësim mesatar jo më pak se 70 (shtatëdhjetë) punonjës për periudhën dhjetor 2019 – nëntor 2020, ka paraqitur vetëm 18 (tetëmbëdhjetë) .
3. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Llazo” shpk me Nr NIPT-i **K24218401K** dhe “Leon Konstruksion” shpk me Nr NIPT-i **K71820009I** rezultojnë me mangësi në dokumentacion dhe konkretisht si më poshtë :

- Në pikën 10 tek dokumentat standarte të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë çertifikatat e cilësisë në gjuhën shqiper, ose të përkthyer dhe të noterizuara si : ISO 39001:2012 “Mbi sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor” *ose ekuivalent*. Për plotësimin e kësaj pike bashkimi i operatorëve ekonomik ka paraqitur çertifikata ISO 39001:2012” lëshuar nga kompania AQScert. KVO gjykon se BS ISO 39001:2012 “Mbi sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor”, lëshuar nga kompania AQScert në emër të shoqërisë “Llazo” shpk dhe “Leon Konstruksion” shpk, nuk është e vlefshme pasi vetë kompania AQScert nuk është e akredituar nga DPA për këtë lloj standarti.
- Shoqëria “Leon Konstruksion” shpk në shtojcën 11 nuk ka deklaruar se është shpallur fitues (kontratat në proces) në procedurën e prokurimit me NR REF-74594-10-08-2020. Mosdeklarimi përbën shkak për skualifikim nga tenderi dhe konsiderohet informacion i rremë .
- Operatori ekonomik “Llazo” shpk nuk ka paraqitur për impiantin e prodhimit të betonit, monitorimin mjedisor të lëshuar 6 muajt e fundit .
- “Llazo” shpk për linjën e pllakave dhe bordurave nuk ka paraqitur leje mjedisi të shoqëruar me çertifikatat ISO 14001:2015 dhe ISO 9001:2015.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur informojmë se bashkimi i operatorëve ekonomik “Fled” shpk me nr nipt-i K17621104C dhe “Shkëlqimi 07” shpk me nr nipt-i K68121808W, me ofertë ekonomike : **64 303 900** (gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e tre mijë e nëntëqind) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme .

Ankesa për vlerësimin, JO .

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë **BASHKISË KUÇOVË**, bashkë me gjithë dokumentacionin e paraqitur për pjesëmarrje në tender, origjinal ose kopje e njehsuar me origjinalin para Noterit Publik , siç parashikohet në dokumentat e tenderit.

Në zbatim të nenit 21, pika 3 paragrafi i parë, të VKM nr. 914 , datë 29.12.2014, jo me vonë se 60 dite nga publikimi i këtij njoftimi, Autoriteti Kontraktor, njofton Operatorin Ekonomik të shpallur fitues. Po në zbatim të bazës ligjore të sipërcituar neni 21 paragrafi i dytë, Operatori Ekonomik, duhet ti përgjigjet kërkesës së Autoritetit Kontraktor brënda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit .

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do te procedohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik ”, i ndryshuar .

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11 / 01 / 2021

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Kreshnik HAJDARI